REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 130, datë 24.08.2016

MBI
MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE "ERNST & YOUNG" SH.P.K., PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHAFP DHE SIK "CREDINS INVEST" SH.A., SI DHE FONDIT TË PENSIONIT DHE FONDIT TË INVESTIMIT NËN ADMINISTRIM PËR VITIN FINANCIAR 2016

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar dhe Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 "Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë audituese "Ernst & Young" sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare për vitin financiar 2016, të shoqërisë SHAFP dhe SIK "Credins Invest" sh.a., si dhe të Fondit të Pensionit Vullnetar Sicred Pensions dhe Fondit të Investimit Credins Premium.

2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve të Pensionit, të Tregut të Fondeve të Investimit dhe të Tregut të Titujve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR **NËNDREJTOR EKZEKUTIV**

Pajtim MELANI **Mimoza KAÇI**